



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0027714-1/25 dt. 23.05.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 40-të

Koha: 23.05.2025 ora 15:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Jeton Rrahmani, Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi dhe Habib Hajdini

Mungoi: Anesa Collaković

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot është thirrur mbledhja e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Diskutim me Drejtorin e Arsimit dhe përfaqësuesit e organizatës “Save the Children” lidhur me bashkëpunimin në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptian.

Rendi i ditës u miratua unanimisht

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani sa i përket Diskutim me Drejtorin e Arsimit dhe përfaqësuesit e organizatës “Save the Children” lidhur me bashkëpunimin në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptian është një temë e rëndësishme mirëpo për shkak të mos pjesëmarrjes në mbledhje të drejtoreshës së Arsimit dhe koordinatores së “Save the Children” këtë çështje do ta diskutojmë në mbledhjen e radhës të cilën do ta mbajmë në koordinim me drejtoreshën e Arsimit, me qëllim që e njëjta të marr pjesë në mbledhje. Drejtoresha e Arsimit ka qenë e ftuar në këtë mbledhje por fatkeqësisht po mungon.

Mbledhja përfundoj punimet në ora 15:25 min.

Mitrovicë
23.05.2025

Procesmbajtës:

Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Komitetit

Jeton RRAHMANI